

**Ligj Nr. xxxxx datë xxxxxx**  
**“Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 197, datë 10.12.2009**  
**“Për Fondet e Pensionit Vullnetar”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

1. Në nenin 4 pikat ç) d) r) rr), 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 14, 15, 16, 40 pika 3, 53, 54, 55, 56, 57/1, 59/1, 60, 61, 66, 68, 69, 75, 88, 108, të ligjit ekzistues pas fjalëve “shoqëri administruese” shtohen fjalët “ofrues i autorizuar në fushën e pensionieve”.
2. Në të gjithë ligjin, fjalët “mbikëqyrje me bazë risku” zëvendësohet me fjalët “mbikëqyrje me bazë rreziku”.

**Neni 2**

**Në nenin 4, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Gërma f) riformulohet si më poshtë:

*“Depozitar” është banka e licencuar nga Banka e Shqipërisë ose një tjetër autoritet përgjegjës në BE për kryerjen e shërbimeve të marrjes në kujdestari, depozitimit dhe marrjes në besim, e licencuar nga Autoriteti për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit vullnetar”.*

2. Gërma g) riformulohet si më poshtë:

---

<sup>1</sup> Direktiva 2003/41/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 3 qershor 2003, mbi aktivitetin dhe

*mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale, Numri CELEX: 32003L0041, Seria L, Nr. 235, datë 23.09.2003, faqe 10-21*

*“Fond pensioni vullnetar” është një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të planit të pensionit personal ose të planit të pensionit profesional, në vijim do të quhet “fond pensioni”.*

3. Gërma gj) riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“Funksionar kryesor” është drejtori i departamentit, drejtorisë ose njësisë në shoqërinë administruese.*

4. Gërma h) riformulohet si më poshtë:

*“Fitimi nga kapitali” është fitimi që rezulton nga diferenca e çmimit të aseteve në momentin e shitjes së tyre.*

5. Në gërmën i) fjala “i vetëm” pas fjalës “organ” shfuqizohet dhe fjalët “me funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje” zëvendësohen me fjalët “me përgjegjësi kryesore për administrimin dhe mbikëqyrjen.”.

6. Në gërmën k) fjala “drejtorët” në fjalinë e dytë zëvendësohet me fjalën “funksionarët kryesorë dhe administratori”.

7. Gërma n) riformulohet si më poshtë:

*“Ligj i shoqërive tregtare” është ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar”.*

8. Pas gërmës p) shtohet gërma p/1) me përmbajtje si më poshtë:

*“Përfitues” është personi i cili merr përfitimet në rast vdekje të anëtarit të fondit të pensionit, dhe që caktohet nga ky i fundit në kontratën e planit të pensionit”.*

9. Gërma q) riformulohet si më poshtë:

*“Punëdhënës: janë të gjithë personat fizikë ose juridikë, që punësojnë persona të tjerë dhe u paguajnë atyre shpërblimin për punën e kryer sipas legjislacionit të punës.”.*

10. Pas gërmës u) shtohen gërmat si më poshtë:

*“v) “Lloj aseti” është klasa ose nën klasa e instrumentave financiare ose aseteve të tjera që kanë karakteristika risku dhe kthimi pothuajse homogjene.*

*x) “Vend anëtar” është vendi anëtar i BE-së, përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e një subjekti që ushtron veprimtari ose synon të ushtrojë veprimtari në Shqipëri ose është Shqipëria*

kur një subjekt i licencuar ushtron veprimtari, ose synon të ushtrojë veprimtari në një nga vendet e BE-së.

xh) “Vend pritës” është një tjetër vend i BE-së në të cilin një subjekt i licencuar në Shqipëri synon të ndërmarrë veprimtari ose ndërmerr veprimtari në përputhje me legjislacionin për punën dhe sigurimet shoqërore të atij vendi.

y) “Legjislacioni për punën dhe sigurimet shoqërore” janë dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve që aplikohen për subjekte të mbikëqyrura nga autoritetet përgjegjëse të një vendi të BE-së ose dispozitat e ligjit të një vendi tjetër anëtar të BE-së që aplikohen mbi subjektet e licencuara në Shqipëri.

z) “Ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve” është subjekti i licencuar/autorizuar në një nga vendet anëtare të BE-së por dhe i autorizuar nga Autoriteti për të shitur në Shqipëri kuota të fondeve të pensioneve që ka nën administrim.

zh) “Fondi me model të gatshëm” është fondi i pensionit i zgjedhur nga shoqëria administruese /ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve, me kushte të përcaktuara nga kjo e fundit, që u ofrohet anëtarëve në rastet kur këta nuk kanë zgjedhur vetë fondin(et) e pensionit ku do të kontribuojnë.””.

### **Neni 3**

#### **Në nenin 5, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

Në fjalinë e fundit të pikës 1, pas fjalëve “kontratës së fondit të pensionit” shtohet fjalët “si dhe në përputhje me dokumentin e politikave të investimit”.

### **Neni 4**

#### **Në nenin 6, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, fjalia e fundit si dhe gërma a) dhe b) shfuqizohen.
2. Në pikën 2, bëhen këto ndryshime:

Pika a) shfuqizohet.

Në gërmën c) në fjalinë e dytë pas fjalëve “...për transferimin e asetëve në një...” shtohet fjala “tjetër”.

Në gërmën ë) dhe f) në fillim të fjalisë shtohen fjalët “...për anëtarët në një plan pensioni personal...”.

3. Në pikën 3, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtje si me poshtë:

*Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve duhet t'i bashkëlidhë kontratës së fondit të pensionit edhe politikën e investimeve, që do të zbatohet për fondin e pensionit, dhe që përfshin të paktën limitet maksimale dhe minimale, në përqindje, të llojeve të aseteve ku fondi i pensionit mund të investohet.*

4. Pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje si më poshtë:

*“4. Çdo ndryshim i kontratës së fondit të pensionit dhe politikës së investimeve do të konsiderohet i vlefshëm pas njoftimit me shkrim të anëtarëve të paktën tre muaj përpara. Ndryshimet e kontratës së fondit të pensionit dhe të politikës së investimit, të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni, mund të kryhen vetëm me miratimin e Autoritetit.”*

## **Neni 5**

**Në nenin 7 bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

*Në fjalinë e parë shfuqizohen fjalët “...dhe jo më vonë se 31 marsi i çdo viti duhet të publikojë një prospekt...”.*

*Fjalia e dytë shfuqizohet.*

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 dhe pika 2/2, me këtë përmbajtje:

*“2/1. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve harton dokumentin me informacionin kryesor për anëtarin e fondit, sipas formës së përcaktuar me rregullore të Autoritetit.*

*2/2. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve dhe agjentët e fondit të pensionit janë të detyruar t'i japin çdo personi përpara nënshkrimit të kontratës për anëtarësim në fondin e pensionit dokumentin me informacion kryesor për anëtarin e fondit. Ky dokument duhet të publikohet në faqen e internetit të shoqërisë administruese/ofruesit të autorizuar të pensioneve. Autoriteti nxjerr rregullore mbi përmbajtjen e detajuar të dokumentit me informacionin kryesor për anëtarin e fondit.”.*

## **Neni 6**

## **Në nenin 8, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pika 1, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“1. Prospekti përmban një përshkrim që paraqet organizimin, detyrat dhe të drejtat e anëtarit të fondit të pensionit, të shoqërisë administruese /ofruesit të autorizuar në fushën e pensioneve dhe të depozitarit, si dhe detaje për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese /ofruesit të autorizuar në fushën e pensioneve.”.*

2. Pika 3, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“3. Prospekti përmban informacion për karakteristikat thelbësore mbi funksionimin e skemës me kontribute të përcaktuara, përfshirë dhe mbajtësin e riskut të investimit.”.*

3. Pika 4, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“4. Prospekti jep një përmbledhje të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme të politikës aktuale të investimeve të fondit të pensionit dhe të profilit të rrezikut të fondit të pensionit.”.*

4. Në pikën 6, në fjalinë e dytë, fjala “shpjegimiet” zëvendësohet me fjalën “Prospekti”

5. Në pikën 7, pas fjalëve “Këshilli i administrimit” shtohet fjalia “...ose organi administrues i ofruesit të autorizuar në fushën e pensioneve...”.

## **Neni 7**

## **Në neni 9, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, në fjalinë e parë pas fjalës “projektkontratës” shtohet fjala “tip”.

2. Në pikën 2, fjalia e dytë dhe e tretë zëvendësohen me fjalinë “Çdo ndryshim i prospektit miratohet nga autoriteti.”.

3. Në pikën 3, në fjalinë e parë para fjalëve “kontratës” dhe “prospektit” shtohet fjala “projekt”.

4. Në pikën 3, në fund të fjalisë së parë shtohet “...duke dhënë arsye në rastin e refuzimit.”.

5. Pas pikës 4, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

*“5. Ky nen zbatohet pavarësisht nëse shoqëria administruese e ofron fondin e pensionit në Shqipëri ose në një vend tjetër anëtar të BE-së. Në rastin e fundit, shoqëria administruuese duhet të kërkojë autorizim nga Autoriteti përgjegjës për të ushtruar veprimtari në atë vend anëtar duke paraqitur kontratën dhe prospektin në përputhje me nenet 6 dhe 9, të këtij ligji si dhe legjislacioni për punën dhe sigurimet shoqërore të atij vendi anëtar.”.*

### **Neni 8**

Në nenin 10, në pikën 2, pas fjalëve *“...të dhëna për depozitarin...”* shtohet fjalia *“...,për punëdhënësin që kontribuon në një plan pensioni profesional si dhe...”*.

### **Neni 9**

**Në nenin 11, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 2, bëhen këto ndryshime:

Në fjalinë e parë pas fjalëve *“...së fondit të pensionit...”* shtohen fjalët *“...që dëshiron të bëhet anëtar i planit të pensionit...”*.

Në fjalinë e parë pas fjalëve *“..shoqëria administruese...”* shtohen fjalët *“.../ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve që ofron disa fonde pensioni...”*.

2. Në pikën 3, fjala *“vullnetar”* pas fjalës *“pensionit”* shfuqizohet.

### **Neni 10**

**Në nenin 12, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 4, në fund shtohen fjalët *“por jo me shumë se 4 shifra pas presjes dhjetore”*.

2. Në pikën 5, fjala *“shumë”* në fjalinë e fundit zëvendësohen me fjalën *“pak”*.

### **Neni 11**

**Në nenin 15, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

Në fjalinë e parë pas fjalës *“Anëtari...”* shtohen fjalët *“... në një plan pensioni personal...”*.

Në fund të fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

*“Anëtari në një plan pensioni profesional ka të drejtë të transferojë asetet e veta nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese / ofruer i autorizuar në fushën e pensioneve nëse ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin, që ka krijuar planin e pensionit, ose punëdhënësi ka ndërprerë kontributet për planin e pensionit.*”

2. Në pikën 2, fjalia *“Nëse anëtari në një fond pensioni “fond i mëparshëm i pensionit”, vendos të bashkohet me...”* zëvendësohet me fjalinë *“Nëse anëtari në një plan pensioni personal vendos të transferojë asetet nga fondi i pensionit aktual tek...”*

3. Në pikën 3, bëhen këto ndryshime:

Pas fjalës *“Anëtari...”* shtohen fjalët *“...në një plan pensioni personal...”*

Pas pikën 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

*“4. Kur shoqëria administruese/ofruer i autorizuar në fushën e pensioneve, në përputhje me kontratën e fondit të pensionit, ofron më shumë se një fond pensioni, plani i pensionit personal duhet të përfshijë një dokument ku të përcaktohen rregullat se si një anëtar mund të zgjedhë të shpërndajë kuotat e tij në një fond ose në disa fonde si dhe shpërndarjen në fonde kur anëtari nuk dëshiron të zgjedhë fondin me model të gatshëm. Asnjë individ nuk mund të detyrohet të bëjë zgjedhje dhe as të zgjedhë fondin me model të gatshëm. Ky dokument duhet të specifikojë mënyrën se si do të përcaktohet dhe si do të ndryshojë shpërndarja e kuotave në rastin e fondit me model të gatshëm në mënyrë që kjo shpërndarje t'i përshtatet rrethanave të veçanta të individit. Një kopje e dokumentit si dhe çdo ndryshim i tij duhet të depozitohet në Autoritet.*”

*5. Kur rregullat e planit të pensionit personal ose profesional parashikojnë se disa ose të gjitha kuotat e anëtarit në një fond me model të gatshëm duhet të transferohen në një tjetër fond pensioni të administruar nga e njëjta shoqëri administruese/ofruer i autorizuar në fushën e pensioneve, shoqëria administruese /ofruer i autorizuar në fushën e pensioneve duhet të njoftojë anëtarin tre muaj përpara propozimit për transferim. Kur ky i fundit kundërshton shoqëria administruese ose ofruer i autorizuar bën vetë transferimin, pa komisione.”.*

## **Neni 12**

Në nenin 16, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

*“3. Shoqëria administruese /ofruer i autorizuar në fushën e pensioneve, 3 muaj përpara se anëtari të arrijë moshën për pension sipas pikat 1, gërma a) të këtij neni, bashkë me vlerësimin aktual të llogarisë individuale të anëtarit duhet t'i japë opsionet mbi mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe t'i japë udhëzime se si mund të zbatohet çdo mënyrë”.*

### **Neni 13**

Në nenin 17, në pikën 2, fjalët “*Tërheqja e parakohshme*” zëvendësohen me fjalinë “*Tërheqja e parakohshme nuk mund të kryhet nëse anëtari ka më pak se 10 vjet anëtarësi në fondin e pensionit. Kur anëtarësia në fond është mbi 10 vjet, tërheqja e parakohshme...*”.

### **Neni 14**

**Në neni 20, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pika 1, riformulohet si më poshtë:

*“1. Shoqëria administruese themelohet si shoqëri aksionare, me kohëzgjatje të pakufizuar, ku të paktën 51 për qind e aksioneve ose e së drejtës së votës zotërohen nga banka ose institucione financiare, të licencuar në Shqipëri ose nga autoritetit përgjegjës i një vendi tjetër anëtar i BE-së. Shoqëria administruese mund të jetë degë e një institucioni financiar të huaj që administron fonde pensioni. Shoqëria administruese duhet ta ketë selinë në Shqipëri. Institucioni financiar i huaj i licencuar nga autoriteti përgjegjës i një vendi anëtar i BE-së për administrimin e fondeve të pensionit mund të themelojë një degë në Republikën e Shqipërisë.”.*

2. Në pikën 2, pas fjalisë së parë shtohen fjalët “*...dhe veprimtarive që lidhen me administrimin e fondit të pensionit.*”.

### **Neni 15**

**Në neni 21, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

Fjalja e parë riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“Shoqëria administruese, në çdo kohë, duhet të ketë një kapital, të mjaftueshëm për të përmbushur të gjitha detyrimet e saj financiare të parashikuara, dhe në çdo rast nuk duhet të jetë më pak se 15 625 000 lekë.”.*

Pas fjalisë së dytë shtohet fjalja me përmbajtje si më poshtë:

*“Kapitali i shoqërisë administruese llogaritet duke zbritur në bilancin e shoqërisë administruese detyrimet nga asetet. Shuma e kërkuar si kapital i nevojshëm për të përmbushur angazhimet financiare të ardhshme, duhet të paraqitet në planin e biznesit 5-vjeçar të shoqërisë, i cili duhet të rishikohet të paktën çdo tre vjet.”.*

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:



Fjalët “kapitalin” zëvendësohen me fjalët “vlerën e kapitalit minimal”

Në fjalinë e dytë në fund shtohet fjalia “me përjashtim të rastit kur një vlerë më e lartë është e parashikuar në plan biznesin e shoqërisë.”.

3. Në pikën 4. Pas fjalëve “...të këtij ligji...” shtohen fjalët “...por mund të jetë subjekt i kufizimeve të tjera dhe...”

4. Pika 5 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“Kur një shoqëri administron një fond pensioni në një vend të BE-së i cili ofron garanci që lidhen me vlerësimin e kuotave në fondin e pensionit, duhet të llogarisë provigjonet teknike për fondin që administron në përputhje me legjislacionin e vendit pritës si dhe të mbajë më vete asetet që u korespondojnë provigjoneve teknike të fondit të pensionit në mënyrë që këto të jenë ligjërish të ndara nga asetet e fondit të pensionit të administruar në Shqipëri. Çdo deficit në fond që lidhet me provigjonet teknike do të përfshihet në provigjonet teknike të vetë shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe duhet të eliminohet brenda 1 viti. Autoritetit kontrollon zbatimin e këtyre kërkesave.”.*

## **Neni 16**

**Neni 24, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

1. Në pikën 2, bëhen këto ndryshime:

Në gjermën c) fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

*c) dokumentet, që vërtetojnë se aksionarët ndikues të shoqërisë, kontrolluesi kryesor, administratori, funksionarët kryesorë, audituesi i brendshëm dhe anëtarët e këshillit të administrimit janë, individualisht e kolektivisht, të përshtatshëm e të aftë për të drejtuar këtë veprimtari.”.*

Në gjermën c) pas pikës iii) fjalia e parë dhe e dytë shfuqizohet.

Në gjermën ç) në pikën i) shfuqizohen fjalët “organizimin e shoqërisë”.

Pas gjermës d) shtohet gjërma d/1) me përmbajtje si më poshtë:

*“d/1) një përshkrim për çdo funksion që delegohet ku të përcaktohet mënyra e kontrollit si dhe detyrimi i të deleguarit për t’i dhënë Autoritetit informacion dhe akses sa herë t’i kërkohet.”.*

Gjërma ë) riformulohet si më poshtë:

*“ë) një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit përkatës, se banka apo institucioni financiar aksionar i aplikantit ka një licencë të vlefshme për të dhënë shërbime financiare në vendin e huaj.”.*

Pas gërmës ë) shtohet gërma f) dhe pikat 2/1, 2/2, 2/3 me përmbajtje si më poshtë:

*“f) një përshkrim të procedurave të shoqërisë për trajtimin e ankesave në përputhje me kërkesat e nenit 30, të këtij ligji.*

*2/1 Nëse shoqëria administruese synon të ofrojë më shumë se një fond pensioni në një vend tjetër anëtar të BE-së, formati dhe përmbajtja e licencës ndryshon. Aplikimi duhet të japë të dhëna se si do të përputhet veprimtaria e shoqërisë administruese me kërkesat e ligjit për punën dhe sigurimet shoqërore të vendit pritës. Nëse shoqëria synon të ofrojë forma të ndryshme garancie, aplikimi duhet të shpjegojë se si do të arrihet përqasja/përputhja me legjislacionin e vendit pritës. Autoriteti nxjerr rregullore ku të përcaktojë detaje të mëtejshme mbi procedurën që duhet të ndjekë një shoqëri nëse ushtron veprimtari jashtë vendit.*

*2/2. Në rastin e degës së një institucioni financiar të huaj që administrojnë fonde pensioni, aplikanti depoziton:*

- a) dokumentin që verteton se është licencuar nga autoriteti përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të fondeve;*
- b) njoftimin e autoritetit përgjegjës për hapjen e degës në Republikën e Shqipërisë;*
- c) regjistrimin e degës;*
- d) objektin e veprimtarisë së degës dhe emrat e personave të autorizuar për të përfaqësuar degën;*
- e) projektkontratën përfshirë politikën e investimit dhe projektprospektin e fondit/fondeve të pensioneve, që do të administrohen sipas kërkesave të këtij ligji;*
- f) planin e biznesit të veprimtarisë së degës;*
- g) çdo informacion tjetër, i përcaktuar në këtë ligj dhe i aplikueshëm për degën.*

*2/3. Të gjitha dispozitat e këtij ligji, të cilat zbatohen për shoqërinë administruese do të zbatohen edhe nga dega e institucionit financiar të huaj që administrojnë fonde pensioni.”.*

## **Neni 17**

**Në nenin 25, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pika 1, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“1. Çdo person, i cili është ose do të jetë aksionar ndikues, kontrollues kryesor, administrator, funksionar kryesor, auditues i brendshëm ose anëtar i këshillit të administrimit në një shoqëri administruese duhet të jetë i përshtatshëm dhe i aftë për të mbajtur pozicionin e caktuar”.*

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me përmbajtje si më poshtë:

*“2/1. Administratori dhe një nga anëtarët e këshillit të administrimit duhet të kenë kualifikim profesional në fushën e investimeve financiare të vërtetuar me certifikatë, të cilat gjykohen nga Autoriteti si të përshtatshme për administrimin e fondeve të pensionit”.*

3. Pika 5 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“Një aksionar ndikues, kontrollues kryesor, administrator, funksionar kryesor, auditues i brendshëm dhe anëtar i këshillit të administrimit i një shoqërie administruese nuk mund të jetë aksionar ndikues, kontrollues kryesor, administrator, funksionar kryesor, auditues i brendshëm dhe anëtar i këshillit të administrimit i depozitarit, që mban asetet e fondit të pensionit të shoqërisë administruese apo të një pale të lidhur me depozitarin”.*

4. Pas pikës 5, shtohen pikat 6, 7, dhe 8 me përmbajtje si më poshtë:

*“6. Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi duhet të përmbushen nga personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni gjatë gjithë kohës që janë në pozicionin përkatës. Autoriteti ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë administruese të vërtetojë përshtatshmërinë dhe aftësinë e tyre sa herë e vlerëson të arsyeshme.*

*7. Autoriteti miraton çdo ndryshim apo riemërim të administratorit dhe anëtarit të këshillit të administrimit. Shoqëria administruese njofton për çdo ndryshim të funksionarit kryesor dhe audituesit të brendshëm dhe përshtatshmërisë së tyre me pozicionin përkatës. Autoriteti miraton çdo ndryshim të statutit të shoqërisë administruese.*

*8. Autoriteti nxjerr rregullore ku të përcaktojë kërkesa të mëtejshme për të qenë i përshtatshëm dhe i aftë në kuptim të pikës 2 të këtij neni si dhe rregulla për procedurat dhe afatet e miratimit të administratorit dhe anëtarit të këshillit të administrimit, si dhe të ndryshimit të statutit të shoqërisë”.*

## **Neni 18**

**Në neni 26, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pika 1, gërma b), riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*b) “çdo aksionar ndikues, kontrollues kryesor, administrator, funksionar kryesor, audituesi i brendshëm dhe anëtari i këshillit të administrimit të shoqërisë është i përshtatshëm dhe i aftë, siç përcaktohet në nenin 25 të këtij ligji;”.*

2. Pas gërmës e) shtohet gërma f) me këtë përmbajtje:

*“f) ka procedura të përshtatshme dhe efektive për delegimin e funksioneve të veçanta, si dhe për monitorimin e kontrollin e tyre”.*

## **Neni 19**

**Në nenin 30, bëhen ndryshimet si më poshtë si më poshtë:**

1. Titulli i nenit ndryshon si më poshtë:

*“Detyrat e administratorit”*

2. Në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

Në gjermën a) fjalët *“kompetencave”* zëvendësohen me fjalët *“funksioneve”*.

Në gjermën c) pas fjalës *“kontrolli”* shtohen fjalët *“...me përjasje me bazë rreziku...”*.

Pas gjermës d) shtohet gjërma e) me përmbajtje si më poshtë:

*“e) të zbatojë procedura efektive të trajtimit të ankesave, që u mundësojnë anëtarëve rivendosjen e të drejtës së shkelur.”.*

3. Në të gjithë përmbajtjen e nenit fjalët *“administratorët”* si dhe *“Çdo administrator”* zëvendësohen me fjalët *“Administratori.”*.

4. Në të gjithë përmbajtjen e nenit foljet në numrin e shumës zëvendësohen në numrin njëjës.

## **Neni 20**

**Në neni 33, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

1. Në pikën 3, të nenit 33, fjala *“drejtor”* zëvendësohet me fjalën *“funksionar kryesor”*.

## **Neni 21**

**Neni 40, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

*“Bashkimi i shoqërisë administruese*

*1. Një shoqëri administruese, e licencuar sipas këtij ligji, mund të blejë dhe të zotërojë aksione në një shoqëri tjetër administruese vetëm kur blen dhe zotëron të gjitha aksionet e shoqërisë administruese të blerë. Blerja nga një shoqëri administruese e të gjitha aksioneve të një shoqërie tjetër administruese konsiderohet bashkim me përthithje dhe bëhet me miratimin paraprak, të autoritetit.*

2. Shoqëria administruese përthithëse, pas bashkimit raporton në autoritet, në përputhje me pikën 2 të nenit 29, të këtij ligji.

3. Shoqëria administruese, e përthithur e cila, si pasojë e bashkimit pushon së ekzistuari, 3 muaj përpara përfundimit të veprimtarisë së saj, duhet të njoftojë të gjithë anëtarët e planit të pensionit personal dhe planit të pensionit profesional për bashkimin me shoqërinë administruese përthithëse, duke iu dhënë mundësi të lidhin kontratë të re me shoqërinë administruese përthithëse, ose ushtrojnë të drejtën për transferimin e aseteve të tyre në një fond tjetër pensioni, të administruar nga një shoqëri administruese/ofrues i autorizuar në fushën e pensioneve, e zgjedhur sipas dëshirës së tyre;

4. Shoqëria administruese e përthithur njofton të gjithë anëtarët e planit të pensionit personal dhe planit të pensionit profesional:

a) për pasojat e mundshme fiskale, që shkaktohen nga përfundimi dhe tërheqja e parakohshme e pagesës nga fondi i pensioneve, përpara arritjes së moshës së pensionit, përfshirë edhe mundësinë për të mos përfituar nga lehtësitë tatimore;

b) për çdo shpenzim që mund t'u ngarkohet nga shoqëria, që ka pushuar së ekzistuari, të tilla si pagesa transanksioni, që do të mbulohen nga shoqëria administruese përthithëse.

5. Asetet e çdo anëtari të planit të pensionit personal, i cili nuk ka vendosur të lidhë një kontratë të re me shoqërinë administruese përthithëse ose me ndonjë shoqëri tjetër administruese, do të transferohen tek shoqëria administruese përthithëse, për sa kohë shoqëria e përthithur konsiderohet si e mbyllur.

6. Në rastin e planit të pensionit profesional, nëse punëdhënësi u ofron punëmarrësve disa fonde pensioni, punëdhënësi zgjedh fondin e pensionit të shoqërisë administruese/ofruesit të autorizuar në fushën e pensioneve që do t'u ofrohet punëmarrësve, si dhe specifikon se cili do të jetë fondi me model të gatshëm. Nëse punëdhënësi nuk zgjedh brenda një kohe të arësyeshme anëtarët do të trajtohen sikur të jenë anëtarë të planit të pensionit personal sipas pikës 4 të këtij neni”.

## **Neni 22**

**Në nenin 41, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

1. Në pikën 2, shfuqizohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

*“Funksione të tjera të një rëndësie të veçantë, siç është administrimi i fondeve, nuk mund të delegohen”.*

## **Neni 23**

**Në nenin 45, bëhen ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:**

1. Pika 3, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“3. Depozitari duhet të mbajë asetet, përfshi mjetet monetare dhe asete të tjera të ngjashme që i përkasin fondit dhe që shoqëria administruese e fondit i ka transferuar në llogaritë e depozitarit, veprimet dhe dokumentet e çdo fondi pensioni, për të cilin kryen shërbimin e depozitarit, të ndara nga njëra-tjetra dhe nga mjetet e veta”.*

2. Pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje si më poshtë:

*“4. Depozitari është përgjegjës sipas ligjit për çdo humbje si pasojë e mos përmbushjes së rolit të tij.”.*

#### **Neni 24**

**Në nenin 46, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6 dhe 7 me përmbajtje si më poshtë:

*“5. Depozitari mban regjistrin e anëtarëve të fondit të pensionit, ku pasqyrohet numri i kuotave dhe vlera neto e aseteve për çdo anëtar.*

*6. Depozitari nuk ka të drejtë të kërkojë tarifa, komisione, apo pagesa të tjera të ngjashme nga anëtari i fondit të pensionit.*

*7. Autoriteti ka të drejtën që, në çdo kohë që e gjykon të arsyeshme dhe të nevojshme për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondit, të kërkojë nga depozitari dhe të disponojë pa kufizim kopje të printuar dhe elektronike të të gjitha të dhënave, dokumentave dhe informacioneve të tjera që lidhen me fondin e pensionit.”.*

#### **Neni 25**

**Në nenin 47, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

Në nenin 47, pika 1, pas fjalëve “nga Banka e Shqipërisë” shtohet fjalët “ose nga një tjetër autoritet përgjegjës në BE”.

#### **Neni 26**

**Në nenin 48, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

Në nenin 48, pika 1, fjalët “Bankën e Shqipërisë” zëvendësohen me fjalët “autoritetin që e licencon si bankë.”.

#### **Neni 27**

**Në nenin 52, bëhen ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:**

1. Në fjalinë e dytë të pikës 1 pas fjalëve "...asetet e depozitarit..." shtohet fjalia "*përfshi mjetet monetare dhe asetet e tjera të ngjashme të fondit të pensionit të cilat shoqëria administruese i ka transferuar në llogaritë e depozitarit,...*".

**Neni 28**

**Në nenin 53, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

1. Në pikën 1, fjalia "*...që do ta ofrojë fondin e pensionit për punëmarrësit e tij..*" zëvendësohet me fjalinë "*Shoqëria administruese mund të krijojë një plan pensioni profesional për punëmarrësit e saj me kusht që të sigurojë ndarjen e asetëve dhe ofrimin e të njëjtës politikë investimi si për punëmarrësit e saj ashtu edhe për anëtarët e tjerë.*".

2. Në pikën 2, bëhen këto ndryshime:

Fjalët "*mund të marrë*" zëvendësohen me fjalët "*merr*".

Gërma b) riformulohet si më poshtë:

*"b) bërë pagesa të rregullta shoqërisë administruese/ofruesit të autorizuar në fushën e pensioneve, për të mbuluar tarifat e këtyre të fundit."*

Pas gërmës b) shtohet gërma c) me përmbajtje si më poshtë:

*"c) derdhur kontribute shtesë në emër të punëmarrësit, të cilat i zbriten nga paga sipas kërkesës së këtij të fundit."*

3. Pika 4, riformulohet si më poshtë:

*"4. Punëmarrësi hyn në fondin e pensionit pasi nënshkruan kontratën e fondit të pensionit me shoqërinë administruese/ofruesin e autorizuar në fushën e pensioneve siç përcaktohet në planin e pensionit profesional që rregullon detyrimin e punëdhënësit për të paguar kontributin."*

4. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me përmbajtje si më poshtë:

*"4/1. Kur shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve ofron më shumë se një fond pensioni, punëmarrësi ka të drejtën të zgjedhë se në cilin fond(e) do të paguhen kontributet, sidoqoftë nëse punëmarrësi nuk është në gjendje të bëjë zgjedhjen e tij, shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve mund ta orientojë punëmarrësin drejt fondit të pensionit që i duket më i përshtatshëm për kushtet e punëmarrësit. Plani i pensionit profesional duhet të lejojë punëmarrësit të lëvizin, pa tarifa, midis fondeve të pensionit, të ofruara nga shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve."*

5. Pika 5, riformulohet si më poshtë:

*5. Punëdhënësi mund të kërkojë që punëmarrësi të jetë i punësuar për një periudhë të caktuar vitesh, para se t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të derdhura nga punëdhënësi, në favor të tij. Nëse marrëdhënia e punës përfundon brenda kësaj periudhe kontributet e bëra nga punëdhënësi mund t'i rikthehen këtij të fundit ose të shpërndahen midis anëtarëve të tjerë të të njëjtit plan, siç është përcaktuar në kontratën e planit të pensionit profesional.”.*

## **Neni 29**

**Neni 54, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

*“Njoftimi në Autoritet i planit të pensionit profesional*

*1. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve njofton Autoritetin për planin e pensionit profesional të krijuar nga punëdhënësi. Funksionimi i planit të pensionit profesional fillon pas 30 ditësh nga njoftimi në Autoritet.*

*2. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve dërgon në Autoritet:*

*a) kopje të kontratës midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese/ofruesit të autorizuar në fushën e pensioneve;*

*b) çdo rregull tjetër që nuk përfshihet në kontratë, por që rregullon planin e pensionit;*

*c) referenca të fondit/fondeve ku do të derdhen kontributet si dhe marrëveshjen në rastin kur kontributet janë të shpërndara në më shumë se një fond;*

*ç) një përshkrim të emrit dhe të karakteristikave të punëdhënësit;*

*d) kushtet e përzgjedhjes për të marrë pjesë në planin e pensionit profesional;*

*dh) marrëveshjen, nëse ka të tillë, që u mundëson punëmarrësve të drejtën e zgjedhjes midis fondeve duke përfshirë edhe mundësinë e përcaktimit të një fondi me model të gatshëm si dhe marrëveshjen për transferimin e menjëhershëm të anëtarëve midis fondeve për arsye të veçanta sic mund të jetë moshë, me përjashtim të rastiit kur punëmarrësi kundërshton;*

*e) kufizimet mbi të drejtën e anëtarit për kontribute të menjëhershme nga punëdhënësi, si dhe kërkesën që punëmarrësi të qëndrojë i punësuar te punëdhënësi, për një numër të caktuar vitesh si dhe marrëveshjen në rastin e kthimit të kontributeve kur punëmarrësi largohet brenda kësaj periudhe;*

*ë) mënyrën e përcaktimit të tarifave, që punëdhënësi duhet t'i paguajë shoqërisë administruese;*

*f) çdo kontribut minimal të mundshëm, të kërkuar për çdo kontribues;*

*g) procedurën e informimit të anëtarëve;*

*gj) kushtet dhe procedurat për përfundimin e pjesëmarrjes dhe transferimin e aseteve të anëtarit në një fond tjetër pensioni;*

*h) kushtet kur punëdhënësi mund të ndërpresë ose reduktojë kontributin tek shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve për punëmarrësit e tij.*

*2. Punëdhënësi duhet të pajisë të gjithë punëmarrësit, të cilët përfitojnë nga plani, me një kopje të kontratës, bashkëlidhur politikën e investimit si dhe çdo rregull tjetër të planit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni. Punëmarrësit duhet të pajisen me një kopje të kontratës dhe çdo rregulli tjetër të fondit edhe kur këto të fundit ndryshojnë”.*



## Neni 30

### Në neni 55, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Titulli i nenit 55, ndryshon si më poshtë:

*“Mospranimi ose korrigjimi i kontratës dhe rregullave të planit të pensionit profesional*

2. Pika 1 dhe 2 riformulohet si më poshtë:

*1. Autoriteti brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për krijimin e planit të pensionit profesional shprehet me shkrim për mospranimin ose korrigjimin e kontratës dhe rregullave të planit të pensionit profesional, nëse, bien ndesh me kërkesat e këtij ligji ose të ligjeve të tjera të zbatueshme. Autoriteti njofton njëkohësisht punëdhënësin dhe shoqërinë administruese/ofruesin e autorizuar në fushën e pensioneve për arsyen e mosprimit apo ndryshimit të dokumentave.*

*2. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve njofton Autoritetin për korrigjimin e dokumenteve në përputhje me kërkesat ligjore. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve njofton Autoritetin për çdo ndryshim të mëtejshëm të kontratës ose të rregullave të planit”.*

## Neni 31

### Neni 56, riformulohet si më poshtë:

*“1. Nëse punëmarrësi ndërpret marrëdhënien e punës, ai vazhdon të mbetet anëtar në fondin/fondet e pensionit personal me shoqërinë administruese/ofruesin e autorizuar në fushën e pensioneve me përjashtim të rastit kur zgjedh të transferojë llogarinë në një tjetër fond(e) pensioni.*

*2. Punëmarrësi, i cili ndërpret marrëdhënien e punës me punëdhënësin, mund të zgjedhë t'i transferojë asetet, sipas planit të pensionit profesional fillestar, te një fond tjetër pensioni, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese/ofrues i autorizuar në fushën e pensioneve ose nga një tjetër, në përputhje me kërkesat e nenit 15 të këtij ligji”.*

## Neni 32

### Në nenin 57, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

*“Pjesëmarrja në një plan pensioni profesional nuk duhet të kufizohet për punëmarrës të caktuar dhe duhet t'u ofrohet të gjithë punëmarrësve pa bërë dallime trajtimi midis punëmarrësve në plan përveçse në lidhje me nivelin e kontributeve”.*

2. Në pikën 3, pas fjalës “të rrisë kontributet” shtohet fjala “individuale”.

### **Neni 33**

**Pas nenit 57, shtohet neni 57/1, me këtë përmbajtje:**

*“Neni 57/1*

*Skeduli i kontributeve*

- 1. Të paktën dy javë përpara fillimit të pagesave për llogari të fondit të pensionit profesional punëdhënësi duhet ta pajisë shoqërinë administruese/ofruesin e autorizuar në fushën e pensioneve me skedulën e kontributeve që do të derdhen për punëmarrësit e mbuluar nga plani duke përfshirë edhe shumën për çdo punëmarrës në çdo fond pensioni. Punëdhënësi duhet të azhurnojë çdo muaj skedulën nëse ka ndryshime në shumat e kontributeve. Skeduli duhet të përfshijë pagesat shtesë në emër të punëmarrësit, pasi t’i jenë ndalur nga paga.*
- 2. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve kontrollon përputhjen e çdo skeduli me kontratën e planit të pensionit profesional, si dhe me kontributet e marra çdo muaj. Në rast mospërputhjesh shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve, brenda një kohe të arsyeshme, njofton punëdhënësin dhe kërkon korrigjimin e skedulit ose të kontributeve të paguara gabim. Nëse punëdhënësi nuk paguan kontribute brenda tre muajve, sic është rënë dakord në skedul, shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve duhet të njoftojë anëtarin dhe Autoritetin.*
- 3. Në rastet e njoftimit për mos pagesën e kontributeve në përputhje me skedulën, Autoriteti ka të drejtë t’i kërkojë punëdhënësit të bëjë pagesat sipas skedulit. Autoriteti ndërmerr veprime në emër të punëmarrësit sipas nenit 57, pika 4.*
- 4. Autoriteti mund të trajtojë rastet e mos pagimit të kontributeve në përputhje me skedulën, si shkelje administrative sipas nenit 102, të këtij ligji.*

### **Neni 34**

**Në nenin 59, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pika 2, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

*“Personi, që vepron si agjent i fondit të pensionit, duhet të jetë person fizik ose person juridik i regjistruar dhe i krijuar sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*

2. Pika 4, shfuqizohet.

3. Në pikën 5, në fjalinë e parë, pas fjalëve “*të fondit të pensionit*” shtohen fjalët “*me vendim të arsyetuar*”.

### **Neni 35**

**Pas nenit 59, shtohet neni 59/1, me përmbajtje si më poshtë:**

*“Neni 59/1*

*Përgjegjësit e agjentit të fondit të pensionit dhe të punësuarve të tyre*

1. *Agjenti i fondit të pensionit duhet të veprojë me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm në përputhje me interesin më të mirë të klientit, si dhe duhet të vlerësojë, para nënshkrimit të kontratës së fondit të pensionit, përshtatshmërinë e fondit të pensionit vullnetar me kushtet dhe rrethanat e klientit.*
2. *Agjenti i fondit të pensioni duhet të mbajë të dhëna të plota për çdo kontratë të nënshkruar dhe për çdo këshillë të dhënë, në çdo rast. Agjenti i fondit të pensioni duhet të ruaj konfidencialitetin për të gjitha informacionet e marra nga klienti. Agjenti i licencuar i fondit të pensioni nuk duhet të nënshkruaj kontratën pa diskutuar më parë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit.*
3. *Agjenti i fondit të pensioni nuk ka të drejtë të kërkojë pagesa apo komisione nga personi me të cilin ka lidhur kontratë ose e ka këshilluar. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensionit mban të dhëna për çdo komision të paguar ndaj agjentit për këto shërbime.*
4. *Shoqëria administruese /ofruesi i autorizuar në fushën e pensioni është përgjegjëse për veprimet dhe mos veprimet e agjentit në lidhje me klientin. Shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioni monitoron veprimtarinë e agjentit të fondit të pensionit me përjashtim të rastit kur përgjegjësia merret përsipër nga subjekti banke, shoqëri sigurimi apo shoqëri komisionere, i cili ka punësuar personin që vepron si agjent i fondit të pensionit. Në rastet e dëmeve të shkaktuara klienteve të fondit të pensionit subjekti me përgjegjësi monitoruese duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin duke specifikuar edhe veprimet që duhet të ndërmerren për të ndaluar shkeljen, dhe kur është e përshtatshme, të japë kompensim ose të rishikojë veprimet që janë ndërmarrë”.*

### **Neni 36**

**Neni 60, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

*“Neni 60*

*Identifikimi i agjentit të fondit të pensionit*

1. Agjenti i fondit të pensionit lidh kontrata të fondit të pensionit vetëm në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese/ofruesit të autorizuar të pensionit, të autorizuar në fushën e pensioneve.
2. Agjenti i fondit të pensionit identifikohet ndaj klientit nëpërmjet licencës të lëshuar nga Autoriteti dhe kontratës me shoqërinë administruese/ofruesin e autorizuar në fushën e pensioneve për të vepruar në emër dhe për llogari të saj/tij. Kur agjenti i fondit të pensionit është i punësuar në një nga subjektet e përmendura në pikën 4, të nenit 59, institucioni për identifikimin e punonjësit që vepron si agjent duhet të sigurohet nga ky subjekt”.

### **Neni 37**

#### **Neni 62, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

“1. Këshilli i administrimit miraton për çdo fond pensioni strategjinë e investimeve, për tre ose më shumë vite si dhe politikën e investimit në prospekt në përputhje me ligjin dhe rregulloret në zbatim të këtij ligji. Politika e investimit duhet të hartohet në mënyrë që të balancojë sigurinë, cilësinë, likuiditetin dhe përfitueshmërinë e investimeve. Këshilli i Administrimit mbikëqyr administrimin e investimeve të fondit të pensionit, siguron që përbërja dhe diversifikimi i tyre të përcaktohen në mënyrën e duhur në politikën e investimit. Strategjia e investimeve duhet të rishikohet të paktën çdo tre vjet dhe veçanërisht kur ka ndryshime thelbësore të kushteve dhe të politikave të investimit si dhe duhet të dërgohet në Autoritet. Në kuptim të kësaj pike, strategjia e investimit përfshin:

- a) shpërndarjen strategjike të aseteve (e cila mund të ndryshojnë tej periudhës së strategjisë së investimeve) me objektivat dhe kufijtë për shumat, që mund të mbahen në lloje të veçanta asetesh;
- b) përcaktimin e qartë të llojeve të instrumenteve financiare dhe të çdo asemi tjetër, në të cilin mund të investohet fondi i pensionit;
- c) rregulla për ruajtjen e aseteve të anëtarëve;
- ç) vlerësimin e përputhjes së ‘duration’ të aseteve dhe të detyrimeve;
- d) procedurën e duhur për përcaktimin e nivelit të nevojshëm të likuiditetit dhe monitorimin në vazhdim të likuiditetit të portofolit sipas këtij niveli;
- dh) analiza që tregojnë se strategjia e politikës së investimit pasqyron profilin e investitorit/anëtarit dhe karakteristikat e ndryshme të riskut dhe të kthimit për llojet e ndryshme të aseteve të disponueshme në fond;
- e) objektivat, për normat e kthimit afatgjatë neto nga inflacioni (të paktën pesë vjet) të fondit si dhe në portofolin referencë kundrejt të cilave mund të krahasohen kthimet aktuale;
- ë) procesin për matjen e rrezikut si dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë me strategjinë dhe administrimin e rezikut të investimeve.

2. Këshilli i administrimit miraton sistemin monitorues të administrimit të rrezikut për fondin/fondet e pensionit. Ky sistem përfshin procesin e kontrollit të përputhshmërisë së portofolit të investimeve me limitet dhe performancën sipas objektivave të strategjisë së investimeve. Sistemi përfshin gjithashtu përcaktimin dhe monitorimin e politikave, me qëllim

identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin, në mënyrë të vazhdueshme, të të gjitha risqeve kryesore”.

#### **Neni 38**

Në nenin 63, në fjalinë e dytë fjalia “brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” shfuqizohet si dhe në fund të fjalisë shtohen fjalët “...dhe afatin e përshtatshëm për korrigjimin e shkeljeve të këtyre kufijve.”.

#### **Neni 39**

**Neni 64, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

“Neni 64  
Huamarrja dhe kreditimi

1. Shoqëria administruese ndalohet të marrë hua për kryerjen e investimeve për interes të fondit të pensionit ose për çdo qëllim tjetër, duke vënë si garanci asetet e fondit të pensionit. Shoqëria gjithashtu nuk duhet të japë hua instrumentat financiarë të fondit të pensionit dhe as të kryejë shitjet të pambuluara të letrave me vlerë të transferueshme, instrumenteve të tregut të parasë ose instrumentave të tjerë financiare”.

#### **Neni 40**

**Neni 65, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

1. Asetet e fondit të pensionit, në asnjë rast, nuk mund të investohen në:
  - a) instrumenta financiare derivative, përveç rasteve kur ato janë përdorur me qëllimin e mbrojtjes ndaj reziqeve të pranishme në llojet e aseteve në portofol, duke përjashtuar rrezikun e kreditit;
  - b) asete fizike të cilat nuk janë të kuotuar në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurtë, të tilla si antike, veprat e artit, mjete motorike, etj;
  - c) aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë të emetuar nga:
    - i) çdo aksionar i shoqërisë administruese;
    - ii) depozitari i fondit të pensionit;
    - iii) çdo person i cili është palë e lidhur në raport me subjektet e listuara në pikën (i) dhe (ii)”.

#### **Neni 41**

**Në neni 66, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

Në pikën b) fjala “fond” zëvendësohet me fjalën “plan”.

Pika c) riformulohet si më poshtë:

*“c) agjenti i fondit të pensionit ose punëmarrësi i personave të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, nuk mund të përhapë ose të bëjë deklarata, që përmbajnë informacione të pavërteta dhe që janë të pa pajtueshme me prospektin, të keqinformojë apo të japë përshtypje të gabuar, me gojë a me shkrim, për një fond pensioni ose një shoqëri administruese/ofrues të autorizuar në fushën e pensioneve, apo produktet e tyre. Punëdhënësi i agjencit ose i punësuarit i personave të përmendur nga gërma (a) deri në gërmën (b) të kësaj pike duhet të sigurohen se agjentët nuk do të japin informacion keq orientues ose të pavërtetë sipas përcaktimit në këtë nen.”.*

2. Në pikën 2, bëhen këto ndryshime:

Para fjalaëve “...është a mund të jetë keqinformues...” shtohen fjalët “...apo produktet e tyre...”

Pas fjalës “shpërndarjen” shtohen fjalët “apo ofrimin e produktit...”.

Fjalët “të caktuar kohe” zëvendësohen me fjalët “të arsyeshëm kohor”.

#### **Neni 42**

**Në nenin 67, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, pas fjalaëve “të padëshirueshme” shtohet fjalët “dhe duke publikuar arsyet pse ka marrë një vendim të tillë”.

2. Në pikën 2, fjalët “vlerësohet si” zëvendësohen me fjalët “deklarohet publikisht si”.

#### **Neni 43**

**Në nenin 68, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, në fjalinë e dytë, fjala “një mënyrë” zëvendësohet me fjalën “formë” dhe fjalët “njerëzit e zakonshëm” zëvendësohen me fjalën “publiku”.

2. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:

*“3. Anëtarit i fondit të pensionit nuk ngarkohet me asnjë shpenzim shtesë përveç tarifës së administrimit të fondit të mbajtur nga shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve.”.*

#### **Neni 44**

**Në nenin 69, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Titulli i nenit ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

*“Tarifat”*

2. Në pikën 1, gërma a) pas fjalëve “për kostot” shtohen fjalët “e arsyeshme të”.
3. Gërma b) e pikës 1 dhe pika 2, riformulohen si më poshtë:

*“b) nëse, me kërkesë të anëtarit, asetet transferohen ndërmjet fondeve të pensioneve që administrohen nga shoqëri të ndryshme administrimi, deri në 0,5 për qind të shumës së transferuar. Kjo tarifë nuk zbatohet në rastin kur transferimi ndërmjet fondeve të pensioneve kryhet kur anëtari ka të paktën 10 vjet të njëpasnjëshme anëtarësi në të paktën një fond.*

*2. Autoriteti nxjerr rregullore që përcaktojnë më hollësisht elementet dhe nivelet e kostos së administrimit, si dhe të tarifave të transferimit. Autoriteti bën publike analizën e efekteve të ndryshimit të niveleve të përcaktuara të kostos së administrimit dhe tarifave të transferimit.”.*

**Neni 45**

**Në nenin 71, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 2, në fund të fjalisë shtohen fjalët “ose atë të ofruesit të pensionit”.
2. Në pikën 4, fjala “Përqasje” zëvendësohet me fjalën “metodologji”.

**Neni 46**

**Në nenin 72, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

1. Në pikën 2, shtohet gërma ç) me këtë përmbajtje:

*“ç) informacion në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë administruese/ofruesi të autorizuar në fushën e pensioneve që veprojnë në Shqipëri ose në një vend tjetër të BE-së.*

**Neni 47**

Në neni 74, në pikën 1, në fund të pikës iv) shtohet fjalia “...për sa kohë autoritete të tilla janë të detyruara të mbajnë konfidencial informacionin që marrin si dhe janë të detyruara ta përdorin atë vetëm për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe që u korrespondon funksioneve të Autoriteti.”.

2. Pas pikës iv) shtohen pikat v) dhe vi) me përmbajtje si më poshtë:

v) falimentimit të një subjekti të licencuar, kur informacioni nuk prek palët e treta dhe mund të shpërndahet gjatë procesit gjyqësor civil ose administrativ;

vi) ndihmën ndaj personave përgjegjës në ushtrimin e funksioneve të tyre gjatë kryerjes së auditimit të fondit të pensionit apo institucioneve të tjera financiare.

3. Pas pikës vi) shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

*“2. Informacioni i marrë nga autoritetet e tjera përgjegjëse gjatë shkëmbimit të informacionit midis tyre, nuk mund të bëhet publik, nëse gjatë kohës së shkëmbimit të këtij informacioni autoritetet kanë rënë dakord që informacioni, të mos përdoret pa aprovimin e tyre. Ky informacioni mund të përdoret vetëm për qëllime për të cilat autoritetet përgjegjëse kanë rënë dakord midis tyre.”.*

#### **Neni 48**

**Në nenin 75, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 4, gërma g) riformulohet me këtë përmbajtje *“plan biznesin sa herë rishikohet”*.

2. Pas gërmës g) shtohet gërma g/1) me këtë përmbajtje *“strategjinë e investimeve sa herë rishikohet”*.

3. Pika 5, riformulohet si më poshtë:

*“Ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve duhet të dorëzojë informacionin e parashikuar në gërmën (f) të pikës 4, të këtij neni”.*

#### **Neni 49**

**Në nenin 79, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pas pikat 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:

*“3. Shoqëria administruese dhe depozitari duhet të sigurojnë ruajtjen e të dhënave, dokumentave dhe informacioneve që lidhen me anëtarët dhe fondin e pensionit. Autoriteti nxjerr rregulla ku përcaktohen afatet e ruajtjes së këtyre të dhënave, dokumentave dhe informacioneve”.*

#### **Neni 50**

**Në nenin 80, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, gërma d) pas fjalës *“kundërshtim”* shtohet fjala *“material”*.



2. Pas gërmës d) shtohet gërma dh) me këtë përmbajtje:

*“është ose mund të jenë në kundërshtim material me dispozitat e ligjit për sigurimet shoqërore dhe punën të vendit pritës kur ai vepron në atë vend”.*

3. Në pikën 2, gërma a) pas fjalëve “në zbatim të tij” shtohet fjalia “ose të legjislacionit për punën dhe sigurimet shoqërore të një vendi tjetër anëtar në BE-së”.

4. Në pikën 2, në gërmën dh) dhe e) shfuqizohen fjalët “tërësisht ose pjesërisht”.

### **Neni 51**

**Në nenin 81, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në nenin 81, në pikën 4, shtohet fjalia “Autoriteti duhet të arsyetojë çdo urdhër të nxjerrë”.

### **Neni 52**

**Në nenin 88, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Titulli i nenit ndryshon si më poshtë:

*“Trajtimi tatimor i kontributeve të anëtarëve të fondit të pensionit”*

2. Pika 1, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

*“1. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni konsiderohet e ardhur e patatueshme dhe zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi. Ky trajtim zbatohet për kontributin dhe transferimin e tij ndërmjet fondeve që administrohen nga shoqëri administrimi të njëjta ose të ndryshme.”.*

3. Pika 3, riformulohet si më poshtë:

*3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni nuk konsiderohen si të ardhura personale të anëtarit dhe përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale të tij. Ky trajtim zbatohet për kontributin dhe transferimin e tij ndërmjet fondeve që administrohen nga shoqëri administrimi të njëjta ose të ndryshme.*

4. Në pikën 4, bëhen këto ndryshime:

Shuma “...200 000 lekë...” zëvendësohet me shumën “...240 000 lekë...”.

Fjalët “..pika 1 e 3..” zëvendësohen me fjalët “...pika 1...”.

Fjalët “...vlerësohet si shërbim financiar dhe për rrjedhojë...” shfuqizohen.

### **Neni 53**

**Neni 89, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:**

*“Kontributet e bëra nga punëdhënësi në favor të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional konsiderohen shpenzime të njohura, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250 000 lekë”.*

### **Neni 54**

**Në neni 90, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

1. Fjalët “...tatohet me tatimin mbi të ardhurat personale...” zëvendësohen me fjalët “..tatohet vetëm për kthimin nga investimi i kontributeve...”.

### **Neni 55**

**Neni 91 shfuqizohet.**

### **Neni 56**

**Në nenin 95, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Titulli i nenin 95, riformulohet me këtë përmbajtje ““Përdorimi i emërtimit “fond pensioni vullnetar” ose “fond pensioni” në kundërshtim me ligjin””.

### **Neni 57**

**Në nenin 106, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Në pikën 1, fjalët në fund “brenda datës 10 të muajit pasardhës” shfuqizohet.

### **Neni 58**

**Në nenin 107, pika 2, shfuqizohet.**

### **Neni 59**

**Në nenin 108, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Pas pikës 5, shtohen pikat 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

*“6. Dispozitat që lidhen me ofruesin e autorizuar në fushën e pensioneve dhe institucione të tjera të një shteti anëtar të BE-së zbatohen vetëm në datën e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.*

*7. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit mund të kryejë njëkohësisht veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit dhe veprimtarinë e administrimit të fondeve të investimit deri në datën e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. E vetmja veprimtari që shoqëria administruese e fondeve të pensionit mund të kryejë pas kësaj date është ajo e administrimit të fondeve të pensionit.”.*

**Neni 60**

**Në nenin 109, shfuqizohet.**

**Neni 62**

Ky ligj në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Kryetari  
Ilir Meta